



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
BASHKIA PËRMET

Nr 3802 / Prot

Përmet më 13 /12 2022

**LENDË:** Dërgim informacioni.

**Qëndrës "Res Publica"**

**ADRESA:** Blv "Gjergj Fishta", Nd24, H.3, Ap.7, Tiranë

Për sa kërkon me tuajën me Nr.230/22, regjistruar nga ana jonë me numër 3802 të protokollit, datë 09.12.2022 drejtuar Bashkisë Përmet ju bëjmë me dije se:

Bazuar V.K.M-së Nr.59 "Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Park Kombëtar (Kategorial) të zonave të mbrojtura mjedisore" u bë ndryshimi i kufijve të Parkut Kombëtar "Bredhi i Hotovës-Dangëlli", në këtë kuadër, me kërkesë të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit sidhe në bashkëpunim me specialistët e Administratës së Zonave të Mbrotitura, Qarku Gjirokastër u bë evidentimi i Ingastrave, sipërfaqeve që do të kalonin nga inventari i pronave të bashkisë Përmet tek Zonat e Mbrotitura dhe anasjelltas, nga ku rezultoi se 1020ha të tipit pyll dhe kullotë nga Ekonomia Pyjore "Petran-Zavalan" dhe ajo kullosore "Frashër-Koblarë" kaluan nga inventari i bashkisë Përmet në Pronësi të Administratës së Zonave të Mbrotitura. Duhet theksuar se këto ngastra ndodhen në brendësi të territorit të Zonave të Mbrotitura, të shkëputura dhe në distancë të largët nga pjesa tjeter e fondit pyjor dhe kulloso r në pronësi të bashkisë Përmet, konkretisht në kufi me qarkun e Korçës dhe të Beratit gjë që e bënte të vështirë monitorimin dhe menaxhimin nga ana e specialistëve të Strukturës përgjegjëse për pyjet dhe kullotat pranë bashkisë Përmet. Gjithashtu ju bëjmë me dije se para miratimit të kësaj V.K.M-je nuk është bërë ndonjë konsultim apo marrje mendimi nga Bashkia Përmet dhe specilistët e saj.

**KRYETARI BASHKISË**

Alma Hoxha

**NË MUNGESË DHE ME POROSI**  
**N/KRYETAR I BASHKISË**

Florand Hasani

